REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 30 maj 2017
Nr. ref.:RK 1086/17

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KO126/16

Gjykata referuese

Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 05/L-120 për Trepçën

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gerxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Gjykata referuese

1. Kërkesa është dorëzuar nga Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: gjykata referuese). Është nënshkruar nga z. Werner K. Kannenberg, gjyqtar në Kolegjin e Specializuar të Dhomës së Posaçme.

Objekti i çështjes

2. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 05/L-120 për Trepçën (në tekstin e mëtejmë: Ligji për Trepçën), i cili është miratuar më 8 tetor 2016, është shpallur më 31 tetor 2016 dhe është publikuar në Gazetën Zyrtare nr. 36 të 31 tetorit 2016.

Baza juridike

3. Kërkesa bazohet në nenin 113.8 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), në nenet 51, 52 dhe 53 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 75 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

4. Më 1 nëntor 2016, gjykata referuese parashtroi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

5. Më 2 nëntor 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Ivan Čukalović dhe Selvete Gërxhaliu-Krasniqi.

6. Më 4 nëntor 2016, Gjykata njoftoi Qeverinë e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Qeveria) dhe Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: AKP).

7. Më 10 nëntor 2016, V. H., avokat nga Prishtina, parashtroi në Gjykatë parashtresën *amicus curiae* të paraqitur pa ftesë nga ana e Gjykatës. Parashtresa në fjalë nuk është marrë parasysh sepse nuk ishte kërkuar nga Gjykata.

8. Më 10 nëntor 2016, Gjykata njoftoi gjykatën referuese se procedurat që kanë të bëjnë me rastin KO126/16, që janë duke u kryer në gjykatën referuese, janë pezulluar deri sa Gjykata Kushtetuese të marrë një vendim për këtë rast.

9. Më 17 nëntor 2016, Qeveria i dërgoi komentet e saj në Gjykatë.

10. Më 21 nëntor 2016, AKP-ja i dorëzoi komentet e saj në Gjykatë.

11. Më 1 dhjetor 2016, Gjykata i dërgoi gjykatës referuese komentet e dorëzuara nga Qeveria dhe nga AKP-ja. Njëkohësisht, Gjykata kërkoi nga gjykata referuese që ta njoftojë Gjykatën nëse është nxjerrë dhe si është nxjerrë vendimi për të referuar kërkesën për vlerësim të kushtetutshmërisë së Ligjit për Trepçën.

12. Më 6 dhjetor 2016, gjykata referuese, nëpërmjet një memorandumi paraqiti përgjigje në pyetjen e Gjykatës dhe komentet e Qeverisë dhe të AKP-së.

13. Më 27 mars 2017, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

14. Më 23 janar 2014, minatori B. B. paraqiti në Gjykatën Themelore në Mitrovicë padi kundër Ndërmarrjes Shoqërore Trepça (në tekstin e mëtejmë: NSH Trepça) për kompensim të dëmit për lëndim të pësuar në punë.

15. Më 25 shtator 2014, Gjykata Themelore në Mitrovicë e shpalli veten jokompetente për të gjykuar këtë rast dhe, më 26 shtator 2014, ia dërgoi çështjen Dhomës së Posaçme në kompetencë lëndore dhe territoriale.

16. Më 23 shkurt 2016, Kolegji i Specializuar ia delegoi rastin C-II-14-0114 gjyqtarit Werner K. Kannenberg për të vendosur si gjyqtar i vetëm në këtë rast.

17. Gjyqtari Werner K. Kannenberg nënshkroi kërkesën e dorëzuar në Gjykatë si një gjyqtar i vetëm në rast.

Pretendimet e gjykatës referuese

18. Thelbi i argumentit të gjykatës referuese për jokushtetutshmërinë e Ligjit për Trepçën ka të bëjë me efektet negative të Ligjit për të drejtat e kreditorëve, të cilët kishin padi kundër NSH Trepça para hyrjes në fuqi të këtij ligji, duke përfshirë edhe paditësin në rastin konkret.

19. Gjykata referuese thekson se Ligji për Trepçën *"ka krijuar një shoqëri aksionare nga një pjesë e mëparshme e NSH (Trepça). Kjo nuk e ndikon juridikisht statusin e NSH-së"*.

20. Gjykata referuese më tej argumenton se *"derisa asetet jothelbësore dhe jofitimprurëse duhet të mbesin nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit (neni 14 paragrafi 1), ligji i bart asetet e vlefshme thelbësore të NSH-së tek shoqëria aksionare (neni 6, paragrafi 3, i cituar në lidhje me nenin 2, paragrafi 2). Mbi të gjitha, ndërmarrja Trepça i humbë të gjitha të drejtat, interesat dhe licencat e vlefshme operacionale, sepse të gjitha këto janë bartur të shoqëria e sapo krijuar"*.

21. Gjykata referuese deklaron se padia në rastin në fjalë, që është në shqyrtim para Kolegjit të specializuar, *"ndërlidhet me njësinë biznesore të minierës Kishnicë dhe Artanë (të cekura në nenin 2 paragrafi 2, nënparagrafi 2), e që për këtë arsye vlefshmëria e Ligjit është relevante për rezultatin e lëndës si për trashëgiminë/identitetin ligjor të së padituës ashtu edhe* për *pyetjen nëse paditësi sipas ligjit është objekt i eksproprijimit jokushtetues pa kompensim"*.

22. Në lidhje me atë rast, gjykata referuese deklaron se *"duke u bazuar në rezultatet e deritashme në shqyrtimin e rastit, sipas vlerësimeve paraprake të Gjykatës, ka shumë të ngjarë që padia do rezultoi të paktën pjesërisht e suksesshme"*.

23. Gjykata referuese më tej argumenton se "*nëse realizohet ndarja e aseteve që shkojnë te shoqëria aksionare ndërsa detyrimet t'i mbesin NSH Trepça, kjo do të ketë edhe implikime të rënda ligjore. Për shkak se është e qartë se transferimi i pronës i kryer sipas ligjit ndikon rëndë në vlerën e çfarëdo padie ndaj NSH-së, faktikisht duke e ulur atë në vlerën zero për kërkesëpaditë e pasiguruara siç është një e tillë e paditësit...prandaj, për shkak të ndikimit mbi të gjithë kreditorët, në kuptim të asaj se i ndanë asetet nga detyrimet, ligji duket të jetë jokushtetues, shkelë garancitë kushtetuese për mbrojtjen e pronës kundër ekspropriimit pa kompensim (neni 46 i Kushtetutës)*".

24. Për më tepër, sipas gjykatës referuese "*duke qenë se 20% e aseteve të marra nga NSH Trepça është kthyer në pronë private, kjo duhet të justifikohet përmes qëllimeve ose interesave publike. Në mungesë të justifikimit të tillë, gjykata konsideron se edhe mbi këtë bazë Ligji është jokushtetues*".

25. Gjykata referuese nënvizon se "*Gjykata Kushtetuese veçse ka marrë vendim lidhur me Ligjin për Trepçën... si rrjedhojë e kërkesës së disa anëtarëve të Kuvendit [...] Ky vendim mbi papranueshmërinë i Gjykatës Kushtetuese nuk e parasheh të njëjtën çështje që është thelb i kërkesës në fjalë*".

26. Në fund, gjykata referuese thekson: "*Pasi që është prerogativë ekskluzive e Gjykatës Kushtetuese që zyrtarisht të anulojë legjislacionin e miratuar nga Kuvendi, Gjykata në pajtim me nenin 113, paragrafi 8, të Kushtetutës, paraqet çështjen e kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 05/L-120 për Trepçën përmes kërkesës drejtuar Gjykatës Kushtetuese*".

Përgjigjja e Qeverisë

27. Qeveria e konsideron kërkesën e gjykatës referuese si të papranueshme, për shkak se e njëjta nuk i ka plotësuar kushtet e pranueshmërisë, të parapara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe me Rregulloren e punës të Gjykatës Kushtetuese.

28. Pasi deklaron se rasti konkret është i njëjtë me rastin KO59/14, ku një gjyqtar parashtron kërkesë individualisht, Qeveria thekon se "*në bazë të dokumenteve në dispozicion shihet qartë se gjyqtari në fjalë nuk ka vendim nga kolegji apo kryetari i Gjykatës Supreme, pjesë e të cilit është Dhoma e Posaçme, për dërgimin ë një kërkese të tillë në Gjykatën Kushtetuese. Kjo procedurë qartë përcaktohet nga neni 113.8 i Kushtetutës, ashtu siç është interpretuar nga Gjykata Kushtetuese në rastet e vendosura si më sipër*".

29. Më tej, Qeveria i referohet Aktgjykimit të Gjykatës në rastin KI25/10, ku "*Gjykata Kushtetuese e ka bërë të qartë se Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme nuk mund të gjykojë ose veprojë kundër misionit primar të Gjykatës Supreme, pjesë e së cilës është vetë Dhoma e Posaçme*". Qeveria thekson se "*[...] konstatimi i gjyqtarit referues se nëse paditë kreditore ndaj NSH Trepça do të pranoheshin si të bazuara në meritë, ndërmarrja e tillë nuk do të ishte likuide për t'i përmbushur ato [...] shkon përtej juridiksionit të tij material sepse ai thjeshtë nuk mund ta supozojë madhësinë e kompensimit që mund të rezultojë nga paditë të cilat akoma nuk i janë nënshtruar shqyrtimit meritor*

dhe të cilat, për aq kohë sa nuk shqyrtohen në meritë, kanë thjeshtë statusin e pretendimeve kreditore".

30. Më tej, Qeveria argumenton se *"gjyqtari referues nuk provon në asnjë mënyrë nevojën e zgjidhjes së një kontesti kushtetues si parakusht që ai të procedojë me zgjidhjen e rastit të tij individual [...] Baza juridiksionale materiale për zgjidhjen e rastit të tillë është Ligji për AKP-në dhe Ligji për Trepçën nuk e cenon në asnjë rrethanë të drejtën e pretenduesve kreditorë për të realizuar të drejtat e tyre në relacion me NSH Trepça dhe AKP-në".*

31. Për më tepër, Qeveria deklaron se *"[...] pretendentët kreditorë të NSH Trepça janë të mbrojtur edhe me parimin e përgjegjësisë jokontraktore të shtetit, që është parim themelor i së drejtës [...]. Megjithatë, një kompensim i tillë do të realizohej vetëm pasi që kreditorët e mundshëm të fitojnë të drejtën e kompensimit përmes një vendimi përfundimtar të Gjykatës, aplikimi i të cilave nuk mund të bëhet për shkak të pamjaftueshmërisë së fondeve të NSH Trepça dhe AKP-së".*

32. Qeveria në vazhdim thekson se *"që t'i lejosh gjyqësorit që në mënyrë hipotetike [...] të konsiderojë një ligj kundërkushtetues përbën shkelje të parimit të ndarjes së pushteteve, ndërhyrje të gjyqësorit në autoritetin e pushtetit legjislativ për të nxjerrë ligje me karakter të përgjithshëm".*

33. Qeveria kërkon nga Gjykata që *"[...] të konstatohet se parashtruesi, gjyqtari individual z. Werner K. Kannenberg, nuk është palë e autorizuar por nuk është as brenda juridiksionit të tij ratione materiae për të parashtruar një kërkesë të tillë ashtu që kjo kërkesë duhet të hidhet poshtë si e papranueshme".*

34. Në fund, Qeveria deklaron se *"në rast se Gjykata Kushtetuese gjen që kërkesa e lartpërmendur* është *e pranueshme, atëherë propozimi i Qeverisë është që kërkesa të refuzohet mbi dy baza: **e para**, si një kërkesë për një çështje res judicata (rasti KO118/16); dhe, **e dyta**, se kërkesa ka ngritur një çështje hipotetike duke prejudikuar sjelljen e shtetit të Kosovës në të ardhmen lidhur me të drejtën për pronë në të gjitha rastet e tjera kontestuese që lidhen me zbatimin e Ligjit për Trepçën, edhe pse akoma nuk ka vendim të organeve gjyqësore kosovare që bazohen në zbatimin e Ligjit për Trepçën dhe interpretimin e tij gjyqësor në rastet konkrete".*

Përgjigjja e Agjencisë Kosovare të Privatizimit

35. AKP-ja njoftoi Gjykatën se *"e paditura në tërësi e kishte kompensuar paditësin sipas marrëveshjes/ujdisë jashtë gjyqësore e cila ishte arritur në mes të palëve më 25 prill 2014, respektivisht 19 shkurt 2015".*

36. AKP-ja më tutje sqaron se *"paditësi B. B. nuk e kishte tërhequr padinë përkundër faktit se ai kishte nënshkruar marrëveshjen dhe kishte pranuar kompensimin për lëndimin në punë, dëmin material dhe atë jomaterial".*

37. Në vazhdim, AKP-ja deklaron se *"Neni 15 i Ligjit për Trepçën ka përcaktuar se pretendimet kreditore* ndaj *Ndërmarrjes Shoqërore Trepça të dorëzuara në*

Agjencinë Kosovare të Privatizimit sipas Ligjit nr. 04/L-035, për Riorganizimin e Ndërmarrjeve të Caktuara dhe Pasurisë së Tyre, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin përkatës, trajtohen sipas ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit [...]. Paragrafi 3 i këtij ligji thekson se 'prej hyrjes në fuqi të këtij ligjit të gjitha të drejtat dhe detyrimet në lidhje me Trepça do të trajtohen në përputhje me ligjin për ndërmarrjet publike".

38. AKP-ja më tutje thekson se *"paditësi B. B. nuk ka paraqitur kërkesë kreditore në AKP. Paditësi ka pretendime të caktuara monetare të cilat janë objekt i një procesi gjyqësor të papërfunduar me vendim meritor. Këto pretendime janë të adresuara kundër një entiteti (Miniera dhe Flotacioni Kishnicë dhe Artanë) i cili nuk është shuar as likuiduar por ka shënuar transformim juridik".*

39. AKP-ja konsideron se *"transformimi i këtyre njësive është transformim i ligjshëm dhe në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Transformimi në SH.A. i disa njësive është në interes të ndërmarrjes dhe punëtorëve".*

Përgjigjet dhe komentet shtesë të gjykatës referuese

40. Në pyetjen e Gjykatës nëse është nxjerrë dhe si është nxjerrë vendimi në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për të referuar kërkesën, gjykata referuese u përgjigj se *"kërkesa në fjalë është nënshkruar nga gjyqtari i vetëm i poshtëshënuar, në përbërjen e duhur për të shqyrtuar lëndën C-II-14-0114, pra, 'Gjykata' në këtë rast".*

41. Gjykata referuese argumenton se çdo përbërje e gjykatës (së rregullt), që ka kompetencë për të vendosur për rastin, mund të paraqesë kërkesë për kontroll incidental në Gjykatën Kushtetuese. Në ndërlidhje me këtë, ajo thekson se *"Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme është pjesë e Gjykatës Supreme. Rrjedhimisht, përbërjet e Dhomës së Posaçme janë përbërje të Gjykatës Supreme. Siç është rasti në çdo vend tjetër, çdo vendim i marrë nga përbërja e paraparë me ligj është vendim i "Gjykatës" dhe për këtë arsye ka dispozita ligjore lidhur me përbërjen e Gjykatës".*

42. Më tutje, gjykata referuese konsideron se *"[...] parashtrimi i kërkesave në Gjykatën Kushtetuese dhe shkëmbimet pasuese të memorandumeve nuk janë veprime administrative. Një gjë e tillë është pjesë e funksionit gjyqësor të gjykatës e cila e bën kërkesën. Prandaj vlejnë të gjitha dispozitat dhe garancitë në procedurën gjyqësore: vetëm gjykata kompetente mund të vendosë, nuk mund të lejohen ndërhyrjet e brendshme apo të jashtme nga personat të cilët nuk janë gjyqtari(ët) përgjegjës për lëndën".*

43. Gjykata referuese deklaron se *"nëse Gjykata Kushtetuese do të jetë e prirur që ta konsiderojë të papranueshëm referimin e tërë ligjit [...] Gjykata kërkon anulimin e dispozitave që marrin asetet e NSH Trepça...".* Në mënyrë të veçantë, ajo kërkon anulimin e dispozitave në vijim: nenin 2 (2) dhe nenin 6 (3); nenin 5 (2) (3) (4) (5).

44. Gjykata referuese thekson se *"kur një person është pronar i një padie, por me anë të ndërhyrjeve ligjore, vlera e padisë së tij bëhet ekuivalente me zero, ai kthehet në pronar të një "nudum ius", e drejta e cila ekziston formalisht dhe pa asnjë vlerë. Pasi që vlera e një padie monetare është ajo që lejon gëzimin e një të drejte, kjo është e mbrojtur me anë të KEDNJ-së sipas Nenit 1 protokollit 1 dhe nenit 14 të KEDNJ-së".*

45. Në fund, gjykata referuese *"[...] fton Gjykatën Kushtetuese që, në interes të paditësit në këtë lëndë, por edhe më në përgjithësi në interes të shoqërisë si tërësi, që t'ia demonstrojë publikut se drejtësia në Kosovë vepron në mënyrë të pavarur dhe mbizotëron mbi autoritetin* [politik], *që ta adresojë padrejtësinë, me qëndrim të vendosur për sa i përket vlerës së kushtetutës ndaj legjislativit dhe politikës në Kosovë. Prandaj kjo Gjykatë sugjeron që kërkesa të konsiderohet se është e pranueshme dhe të urdhërojë kompensimin e përshtatshëm".*

Dispozitat përkatëse ligjore dhe kushtetuese

Dispozitat përkatëse kushtetuese:

Neni 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor]

1. Pushteti gjyqësor në Republikën e Kosovës ushtrohet nga gjykatat.

2. Pushteti gjyqësor është unik, i pavarur, i drejtë, apolitik e i paanshëm dhe siguron qasje të barabartë në gjykata.

Neni 46 [Mbrojtja e Pronës]

1. E drejta e pronës është e garantuar.
2. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.
3. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëj ekspropriimin e pronës nëse ky ekspropriim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave ekspropriohet.
4. Kontestet që lindin nga akti i Republikës së Kosovës ose autoritetit publik të Republikës së Kosovës për të cilat pretendohet se përbëjnë ekspropriimin, do të zgjidhen nga gjykata kompetente.
5. Prona intelektuale mbrohet me ligj.

Dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Neni 9 [Mbajtja e procedurës nga nën-kolegji apo gjyqtari i vetëm]

1. Çdo kolegj i specializuar i Dhomës së Posaçme mund të lëshojë urdhër

për t'ia deleguar njërit prej anëtarëve të tij, apo një nën-kolegji që përbëhet nga dy anëtarë të tij, përgjegjësinë dhe autoritetin për të mbajtur një pjesë apo procedurën e plotë për një rast që është juridiksion i fushës së tij. Aktgjykimet dhe aktvendimet e dhëna nga një gjyqtar i tillë i vetëm apo nën-kolegji të tillë do të konsiderohet të jetë lëshuar nga kolegji i plotë i specializuar në fjalë.

Dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 05/L-120 për Trepçën

Neni 2 [Fushëveprimi]

1. Dispozitat e këtij ligji përcaktojnë transformimin e njësive biznesore të listuara në paragrafin 2. të këtij neni në Shoqërinë Aksionare Trepça Sh.A.

2. Njësitë biznesore të Trepça Sh.A. janë:
2.1. Minierat me Flotacion Trepça - Stan Tërg (Fi 690/89);
2.2. Minierat me FlotacionKishnicë dhe Artanë (Fi 349/88);
2.3. Minierat me FlotacionKopaonik - Leposaviç (Fi 804/89).

Neni 5 [Resurset Minerale, bartja e pasurisë, të drejtave dhe burimeve njerëzore]

2. Trepça Sh.A. hulumton dhe shfrytëzon resurset minerale në bazë të licencës për hulumtim dhe shfrytëzim të lëshuar në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.

3. Të gjitha të drejtat, interesat dhe licencat e vlefshme operuese të Ndërmarrjes Shoqërore Trepça kalojnë në Trepça Sh.A.

4. Të gjithë punëtorët të cilët kanë kontratë të rregullt pune në njësinë biznesore të definuar me këtë ligj, në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji vazhdojnë marrëdhënien e punës në njësinë përkatëse biznesore.

5. Trepça Sh.A. trashëgon të drejtën e valorizimit të mbetjeve teknologjike nga e kaluara dhe trajtimin e tyre në përputhje me standardet mjedisore dhe studimin e fizibilitetit.

Neni 6 [Statuti]

3. Asetet e Trepça Sh.A. përbëhen nga asetet e njësive biznesore të përcaktuara me këtë ligj dhe vlera e tyre përcaktohet në statut, duke u bazuar në studimin e fizibilitetit dhe me metodat standarde të vlerësimit.

Neni 14

1. Asetet e tjera të ndërmarrjes shoqërore "Trepça", të cilat nuk transformohen me këtë ligj në Trepça Sh.A., do të trajtohen sipas rekomandimeve të studimit të fizibilitetit. Asetet jothelbësore dhe joprofitabile do të mbeten në menaxhim të AKP-së për t'iu nënshtruar privatizimit ose likuidimit në përputhje me ligjin.

KAPITULLI VIII PRETENDIMET E KREDITORËVE

Neni 15

1. Pretendimet kreditore ndaj Ndërmarrjes Shoqërore Trepça të dorëzuara në Agjencinë Kosovare të Privatizimit sipas ligjit Nr. 04/-L-035 për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin përkatës, trajtohen sipas ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

2. Pretendimet tjera të mundshme kreditore ndaj Ndërmarrjes Shoqërore Trepça të paraqitura deri në datën e vendosjes në likuidim të aseteve sipas nenit 14 të këtij ligji, trajtohen sipas ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

3. Prej hyrjes në fuqi të këtij ligji të gjitha të drejtat dhe detyrimet në lidhje me Trepça SH.A. do të trajtohen në përputhje me ligjin për ndërmarrjet publike.

E drejta krahasuese

46. Gjykata vëren se një numër i madh i shteteve evropiane parasheh të ashtuquajturën "procedurë paraprake të vendosjes", nëpërmjet të cilës një gjykatë e rregullt e ngrit çështjen e kushtetutshmërisë së aktit të legjislacionit në Gjykatën Kushtetuese, kur ka dyshime nëse dispozitat specifike të një akti legjislativ që duhet zbatuar në një rast konkret gjyqësor janë apo jo në përputhje me Kushtetutën. Kjo procedurë emërtohet në mënyra të ndryshme, ndërsa në terminologjinë e drejtësisë kushtetuese në Kosovë njihet si "kontroll kushtetues incidental".

47. Nga analiza krahasimtare mund të shihet se gjykatat e rregullta të shumicës së shteteve evropiane janë të autorizuara të parashtrojnë kërkesë në gjykata kushtetuese për vlerësimin e kushtetutshmërisë së dispozitave specifike ligjore (në disa vende edhe të akteve të tjera), të cilat duhet të zbatohen drejtpërdrejt në një rast gjyqësor konkret. Një autorizim i tillë ekziston në Shqipëri, në Armeni, në Belgjikë, në Bosnjë dhe Hercegovinë, në Kroaci, në Republikën Çeke, në Hungari, në Itali, në Maqedoni, në Rumani, në Slloveni, në Spanjë, në Turqi. Në disa shtete, si: në Bullgari, në Greqi dhe në Letoni, vetëm gjykatat më të larta janë të autorizuara për inicimin e kontrollit incidental në gjykatat kushtetuese.

48. Analiza krahasuese vë në pah këto elemente të përbashkëta të kontrollit kushtetues incidental: Së pari, duhet të ekzistojë një rast konkret në shqyrtim pranë gjykatave të rregullta; së dyti, duhet të ekzistojë një dyshim i arsyetuar se dispozita përkatëse ligjore që duhet zbatuar drejtpërdrejt për zgjidhjen e rastit nga gjykata e rregullt mund të jenë në shpërputhje me Kushtetutën; dhe së treti, gjykatat e rregullta duhet të ndjekin një procedurë të caktuar për referimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese.

Pranueshmëria e kërkesës

49. Gjykata fillimisht duhet të shqyrtojë nëse janë plotësuar kriteret për pranueshmëri të kërkesës, të parashikuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

50. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet fillimisht nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili parasheh:

> *1. "Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar,*
> *(...)*
> *8. Gjykatat kanë të drejtë t'i referojnë Gjykatës Kushtetuese çështje përkitazi me përputhshmërinë kushtetuese të një ligji, nëse ajo përputhshmëri është ngritur gjatë procedurës gjyqësore dhe gjykata referuese nuk është e sigurt për përputhshmërinë e ligjit të kontestuar me Kushtetutën dhe nëse vendimi i gjykatës referuese për rastin e caktuar, varet nga përputhshmëria e ligjit në fjalë".*

51. Përveç kësaj, Gjykata i referohet neneve 51, 52 dhe 53 të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

> *Neni 51 [Saktësimi i kërkesës]*
>
> *1. Kërkesa e ngritur në pajtim me nenin 113, paragrafi 8 të Kushtetutës, do të parashtrohet nga gjykata vetëm nëse ligji i kontestuar duhet të zbatohet drejtpërsëdrejti në çështjen që është pjesë e lëndës në shqyrtim dhe vetëm nëse ligjshmëria e ligjit të kontestuar është parakusht për marrjen e vendimit nga ana e gjykatës.*
>
> *2. Kërkesa do të specifikoj cilat dispozita të ligjit konsiderohen në kundërshtim me Kushtetutën.*
>
> *Neni 52 [Procedura para gjykatës]*
>
> *Pas ngritjes së kërkesës në pajtim me nenin 113, paragrafi 8 të Kushtetutës, procedura para gjykatës referuese do të suspendohet deri në nxjerrjen e një vendimi nga ana e Gjykatës Kushtetuese.*
>
> *Neni 53 [Vendimi]*
>
> *Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për pajtueshmërinë e dispozitës ligjore me Kushtetutën dhe nuk vendos për çështje të tjera faktike ose juridike që kanë të bëjnë me kontestin para gjykatës referuese.*

52. Gjykata i referohet edhe rregullave 75 dhe 76 të Rregullores së punës, të cilat përcaktojnë:

Rregulli 75 [Parashtrimi i kërkesës]

1. Çdo gjykatë e Republikës së Kosovës mund të parashtrojë kërkesë në Gjykatë, në pajtim me nenin 113.8 të Kushtetutës, ex officio, ose me kërkesë të njërës palë të përfshirë në lëndë.

2. Kërkesa duhet të theksojë përse vendimi i Gjykatës varet nga çështja e përputhshmërisë së ligjit me Kushtetutë. Dosja, e cila shqyrtohet nga Gjykata, duhet t'i bashkëngjitet kërkesës.

3. Çdo gjykatë e Republikës së Kosovës mund të parashtrojë kërkesë për të iniciuar procedurën në pajtim me dispozitat e nenit 113.8 të Kushtetutës, pavarësisht nëse një palë e përfshirë në lëndë ka kontestuar kushtetutshmërinë e dispozitës përkatëse ligjore.

Rregulli 76 [Njoftimi]

Gjykata, pas parashtrimit të kërkesës, e urdhëron gjykatën që të pezullojë ndonjë procedurë që është duke u zhvilluar përkitazi me rastin në fjalë, derisa Gjykata të ketë lëshuar një vendim.

53. Gjykata vëren se, ndryshe nga shumë vende të tjera, në Republikën e Kosovës praktika e kërkesave për shqyrtimin e kushtetutshmërisë së normave ligjore nga gjykatat e rregullta kufizohet në dy raste (përkatësisht, rasti KO04/11 dhe KO5/14).

54. Në rastin konkret, në mënyrë që t'i shqyrtojë kriteret e pranueshmërisë, Gjykata duhet që fillimisht të vlerësojë nëse gjykata referuese është e autorizuar për të parashtruar një kërkesë të tillë.

55. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton se në Aktvendimin për papranueshmëri në rastin KO59/14, ajo ka përcaktuar se e drejta e gjykatave të rregullta për të referuar kërkesën për vlerësim të kushtetutshmërisë së normave juridike buron nga neni 113, paragrafi 8, i Kushtetutës. Megjithatë, në përputhje me këtë nen, "gjykata" është palë e autorizuar dhe jo *"gjyqtarët"* (shih rastin Gjykata Kushtetuese, KO59/14, Aktvendim i 14 korrikut 2014). Këtë qëndrim, Gjykata e arsyetoi duke u referuar në dallimin që e bën Kushtetuta dhe Ligji për gjykatat, ndërmjet "gjykatave" dhe "gjyqtarëve".

56. Megjithatë, Gjykata konsideron se rrethanat e rastit konkret dallojnë në thelb nga ato të rastit KO59/14. Kështu, në rastin KO59/14, kërkesa ishte referuar nga Kryetari i trupit gjykues (të Departamentit për Krime të Rënda), në një rast në të cilin gjykata duhej të gjykonte në trup gjykues. Për më tepër, në këtë rast, Kryetari i Gjykatës Themelore përkatëse, të cilës i përkiste gjyqtari, informoi Gjykatën Kushtetuese se brenda Gjykatës Themelore nuk ishte marrë asnjë vendim për të referuar rastin për kontroll incidental të kushtetutshmërisë.

57. Në rastin konkret, gjykata referuese e gjykon çështjen nëpërmjet një gjyqtari të vetëm, në pajtim me nenin 9 [Mbajtja e procedurës nga nën-kolegji apo gjyqtari i vetëm] të Ligjit nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës

Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i cili përcakton:

"1. Çdo kolegj i specializuar i Dhomës së Posaçme mund të lëshojë urdhër për t'ia deleguar njërit prej anëtarëve të tij, apo një nënkolegji që përbëhet nga dy anëtarë të tij, përgjegjësinë dhe autoritetin për të mbajtur një pjesë apo procedurën e plotë për një rast që është juridiksion i fushës së tij. Aktgjykimet dhe aktvendimet e dhëna nga një gjyqtar i tillë i vetëm apo nënkolegj i tillë do të konsiderohet të jetë lëshuar nga kolegji i plotë i specializuar në fjalë".

58. Gjykata rikujton se Kolegji i Specializuar ia ka deleguar rastin gjyqtarit Werner K. Kanenberg për ta vendosur si një gjyqtar i vetëm në atë rast. Prandaj, *"(...) vendimet e dhëna nga një gjyqtar i tillë i vetëm (...) do të konsiderohen të jenë lëshuar nga kolegji i plotë i specializuar në fjalë"*, përkatësisht për qëllimet e nenit 113, paragrafi 8, të Kushtetutës i cili i autorizon "gjykatat" të referojnë çështjet e përputhshmërisë kushtetuese të një ligji në Gjykatën Kushtetuese.

59. Gjykata konsideron se, në pajtim me nenin 113, paragrafi 8, të Kushtetutës, "gjykatë" është çdo gjyqtar ose kolegj gjyqtarësh që ka kompetencë të plotë për të gjykuar meritat e një rasti në pritje përpara saj.

60. Prandaj, duke marrë parasysh sqarimet e mësipërme, Gjykata konsideron se kërkesa është dorëzuar nga "gjykata" në kuptim të nenit 113.8 të Kushtetutës.

61. Më tutje, Gjykata rikujton nenin 51 të Ligjit, i cili parasheh:

"1. Kërkesa e ngritur në pajtim me nenin 113, paragrafi 8 të Kushtetutës, do të parashtrohet nga gjykata vetëm nëse ligji i kontestuar duhet të zbatohet drejtpërsëdrejti në çështjen që është pjesë e lëndës në shqyrtim dhe vetëm nëse ligjshmëria e ligjit të kontestuar është parakusht për marrjen e vendimit nga ana e gjykatës.

2. Kërkesa do të specifikoj cilat dispozita të ligjit konsiderohen në kundërshtim me Kushtetutën."

62. Nga sa u tha më lart, rezulton se me qëllim që kërkesa e parashtruar sipas nenit 113, paragrafi 8, të Kushtetutës, të jetë e pranueshme, ajo duhet të përmbushë kriteret e mëposhtme:

a) gjykata referuese duhet të ketë lëndën në shqyrtim e sipër;
b) ligji i kontestuar duhet të zbatohet drejtpërdrejt nga gjykata referuese në lëndën në shqyrtim e sipër;
c) ligjshmëria e ligjit të kontestuar është parakusht për vendimin mbi çështjen në pritje; dhe
d) gjykata referuese duhet të specifikojë se cilat dispozita të ligjit të kontestuar konsiderohen të papajtueshme me Kushtetutën.

63. Gjykata thekson se si kusht themelor, i përcaktuar shprehimisht edhe në Ligj dhe në Rregullore, për pranueshmëri të një kërkese për kontroll incidental të

kushtetutshmërisë, është ekzistenca e të ashtuquajturit "element i lidhshmërisë" së drejtpërdrejtë ndërmjet dispozitave të ligjit të kontestuar dhe objektit të çështjes që është në gjykim para gjykatave të rregullta.

64. Gjykata konsideron se *"zbatimi i drejtpërdrejtë"* i normës konkrete nënkupton se nga zbatimi apo moszbatimi i drejtpërdrejtë i normës varet rezultati i vendimit nga ana e gjykatës referuese.

65. Gjykata vëren se ky interpretim mbështetet nga praktika gjyqësore e vendeve të tjera. Kështu, Gjykata Kushtetuese e Gjermanisë thekson elementin lidhës ndërmjet normës së kontestuar dhe rastit konkret duke arsyetuar se *"[...] nëse Gjykata do të shpallte jokushtetuese dispozitat e kontestuara do të refuzohej padia, ndërsa nëse shpallja e atyre dispozitave si kushtetuese do të rezultonte me aprovimin e padisë" (shih Vendimin e Gjykatës Federale Kushtetuese të Gjermanisë 2 BvL 12, 13 , 14, 15/56 i 6 nëntorit 1957).*

66. Në të njëjtën linjë, Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë argumenton se *"parashtruesi i kërkesës duhet të krijojë mendimin se ligji që ai vlerëson si antikushtetues do të zbatohet për zgjidhjen e çështjes. Në të kundërtën, nëse parashtruesi i kërkesës vlerëson se një ligj nuk do të zbatohet nga ana e tij për zgjidhjen e çështjes edhe pse sipas tij, është antikushtetues, duhet të vazhdojë me gjykimin e çështjes... (Shih Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë-Vendimi V-30/10 i 17 qershorit 2010 dhe Vendimi nr. 13, i 4 majit 2009)".*

67. Gjykata vëren se, në rastin në fjalë, procedura para gjykatës së rregullt (Kolegji i Specializuar) kishte filluar sipas *"padisë për kompensim dëmi"* për dëmet e shkaktuara në vendin e punës. Në anën tjetër, gjykata referuese thekson se *"padia në fjalë ndërlidhet me njësinë biznesore të minierës Kishnicë dhe Artanë (të cekura në nenin 2 paragrafi 2, nënparagrafi 2), e që për këtë arsye vlefshmëria e Ligjit është relevante për rezultatin e lëndës si për trashëgiminë/identitetin ligjore të së padituës ashtu edhe për pyetjen nëse paditësi sipas ligjit është objekt i eksproprijimit jokushtetues pa kompensim".*

68. Pas shqyrtimit të pretendimeve të parashtruesit dhe shkresave të lëndës, Gjykata vëren se asnjë nga dispozitat e Ligjit për Trepçën nuk duhet të zbatohen drejtpërsëdrejti në procedurën e vendosjes së meritave të rastit para gjykatës referuese. Ligji për Trepçën nuk rregullon vetë zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në lidhje me pretendimet e kreditorëve ndaj Trepçës. Përveç kësaj, Ligji për Trepçën përcakton shprehimisht, në nenin 15, se janë dy ligje të tjera që zbatohen drejtpërdrejt ndaj të gjitha pretendimeve kreditore, përkatësisht Ligji për Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe Ligji për Ndërmarrjet Publike.

69. Gjykata vëren se i thelbi i kërkesës përfshihet në argumentin se Ligji për Trepçën e bën të pazbatueshëm pretendimin e kreditorit dhe, rrjedhimisht, hipotetik. Ky argument presupozon se hyrja në fuqi e Ligjit për Trepçën e bën joefektiv çfarëdo mjeti juridik, të cilin paditësi, në cilësinë kreditorit potencial, do të mund ta ndiqte, duke e bërë të paefektshme çdo mundësi për të pasur një trajtim adekuat gjyqësor të kërkesës së tij.

70. Për më tepër, Gjykata vëren se gjykata referuese parashikon *a priori* rezultatin e procedurës gjyqësore, duke u shprehur: "*Duke u bazuar në rezultatet e deritashme në shqyrtimin e rastit, sipas vlerësimeve paraprake të gjykatës, ka shumë të ngjarë që padia do rezultojë të paktën pjesërisht e suksesshme*".

71. Gjykata thekson se nuk është brenda fushëveprimit të juridiksionit të saj të bëjë interpretim kushtetues të dispozitave përkatëse ligjore, duke u nisur nga parashikime hipotetike lidhur me mënyrën se si gjykatat e rregullta mund të bëjnë zbatimin e tyre në të ardhmen.

72. Përveç kësaj, Gjykata vëren se, në thelb, gjykata referuese argumenton jokushtetutshmërinë e tërë Ligjit për Trepçën – jo vetëm të dispozitave përkatëse të tij dhe e bën argumentin duke pretenduar se ky ligj cenon të drejtat e të gjithë kreditorëve potencialë ndaj NSH Trepça.

73. Rrjedhimisht, gjykata referuese nuk elaboron se cilat dispozita të Ligjit për Trepçën i konsideron në kundërshtim me Kushtetutën. Vetëm i përmend disa nga nenet e Ligjit për Trepçën, duke kërkuar vlerësimin e kushtetutshmërisë së tyre si zgjidhje alternative, përkatësisht vetëm "*nëse Gjykata do të jetë e prirur që ta konsideroj të papranueshëm referimin e tërë ligjit*".

74. Gjykata konsideron se vetëm referimi në disa nene të ligjit të kontestuar nuk nënkupton specifikimin e tyre, siç kërkohet me nenin 51 (2) të Ligjit. Rrjedhimisht, kjo nuk është në përputhje me kërkesën për arsyetim të pasigurisë përkitazi me pajtueshmërinë kushtetuese të neneve specifike të Ligjit.

75. Gjykata rikujton se, në përputhje me nenin 113.8 të Kushtetutës, kontrolli incidental i kushtetutshmërisë është procedurë e vlerësimit të kushtetutshmërisë së normave konkrete/dispozitave të specifikuara të ligjit dhe nuk është procedurë e kontrollit abstrakt të kushtetutshmërisë. Kushtetuta e Republikës së Kosovës nuk ua njeh gjykatave të rregullta autorizimin për të referuar kërkesën e kontrollit abstrakt të akteve të legjislativit.

76. Përveç kësaj, Gjykata rikujton Aktvendimin e saj për papranueshmëri në rastin KO118/16, të 31 tetorit 2016, në të cilin Gjykata ka bërë vlerësimin *in abstracto* të kushtetutshmërisë së Ligjit për Trepçën.

77. Përfundimisht, Gjykata konsideron se kërkesa nuk mbështet argumentimin se dispozitat e ligjit të kontestuar zbatohen drejtpërdrejt në procedurën që po zhvillohet para gjykatës referuese dhe nuk specifikon në mënyrë të mjaftueshme se cilat dispozita të ligjit konsiderohen në kundërshtim me Kushtetutën dhe përse janë në kundërshtim.

78. Prandaj, Gjykata konstaton se gjykata referuese nuk i ka mbështetur pretendimet e veta, prandaj kërkesa është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.8 të Kushtetutës, me nenet 51, 52 dhe 53 të Ligjit dhe me rregullat 36 (2) (d) dhe 75 të Rregullores së punës, më 27 mars 2017, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Bekim Sejdiu

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi